



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 32 dt.27.03.1996

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dt.27.03.1996, mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Komisioni i Kthimit dhe Kompesimit të Pronave ish Pronarëve (me vendim Nr.312, dt.14.11.1995 të ish pronarit Anton Lufi, të studiuar dhe miratuar nga Komisioni i Shërbimeve Publike të këtij Këshilli

VENDOSI

1. Mbi bazën e ligjit Nr.7689, dt.15.04.1993 Anton Lufi (trashëgimtarët e tij) kompesohen me truall të lirë shtetëror me sipërfaqe 450 m² (si një pjesë e kompesimit të truallit prej 880m² të njohur nga Komisioni i Kthimit dhe Kompesimit të Pronave ish Pronarëve) sipas gen – planit të hartuar nga Kadastra Urbane i cili ndodhet në hapësirën midis pallateve Italiane pranë shkollës “Emin Duraku”.
2. Me vendimin e KRRT-së Nr.7, dt.19.03.1996 janë miratuar kondicionet urbanistike të sheshit të ndërtimit për banesë 6 kate me bodrum.
3. Prona e Anton Lufit është e regjistruar me vendim hipotekor Nr.348, dt.16.04.1928.

KRYETARI

BESNIK PETRELA